3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

-
- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6	7
Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia e Sipërfaqes për pastrim (48 muaj)	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (4 x 5)	
A	Pastrim i brendshëm					
1.	Shërbim pastrim i brendshëm	m ²	11,534,204.4			
B.	Pastrim i jashtëm					
2.	Fshirje rrugësh	m ²	7,927,800			
3.	Larje rrugësh	m ²	4,995,600			
					Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						

Çmimi total me TVSH:		
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit		
Nënshkrimi		
Vula		
Datë _____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të Shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendëshme dhe të jashtme" të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali", Vlore"

Pastrimi i brendshëm i organizuar nga ana e një sipërmarrje private që ka për detyrë pastrimin dhe dezinfektimin përditshëm në të 365 ditët e vitit e të gjitha sipërfaqeve të pavioneve, dhomat e të sëmurëve, ballkonet, korridoret, tualete, dhoma dushi, dhomat e shërbimit për mjekët, infermierët, kabinetet, zyrat, ambientet e shfrytëzueshme në bodrume dhe shkallët deri në dalje nga ndërtesa; bën pastrimin dhe dezinfektimin e mureve dhe inventarit në dhoma, sipas specifikimeve teknike si më poshtë :

Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të bëhet çdo ditë sipas specifikave të mëposhtme:

➤ **Dhomat e pacientëve** të pastrohen jo më pak se 3 (tre) herë në ditë dhe në raste të vecanta edhe më tepër sipas nevojës. Gjate 8 orarshit për secilin turn do behet mirmbajtja e pastrimit të ambienteve ku secili turn do të mbulojë nevojat për pastrim të sipërfaqes së dyshemesë. Me pastrim të dhomës do të kuptohet marrja e pluhurave mbi mobiljet dhe çdo paisjeje tjetër që ndodhet brënda sipërfaqes së dhomës. Larje të Dyshemesë me solucione të lejueshme për përdorim në ambientet spitalore. Qeset e mbeturinave të zbrazen jo më pak se dy herë në ditë dhe sipas rastit në çdo moment të ditës. Pastrimi në dhoma nuk bëhet në orarin e ngrenies së ushqimit dhe në oraret e kryerjes së vizitave të mjekut.

➤ **Korridoret, shkallët dhe ashensorët** të pastrohen jo më pak se 3 (tre) herë në ditë dhe në raste të vecanta edhe më tepër sipas nevojës. Gjate 8 orarshit për secilin turn do behet mirmbajtja e pastrimit të ambienteve ku secili turn do të mbulojë nevojat për pastrim të sipërfaqes së dyshemesë. Solucionet që do të përdoren duhet të jenë të lejueshme për këto ambiente.

➤ **Pastrimi i Tualeteve** në dhomat e pacientëve do të bëhet sipas nevojave ditore në pavione. Për tualetet kolektive jo më pak se 4 herë në ditë. Tualetet e personelit të pastrohen 3 herë në ditë sipas turneve. Mbas çdo pastrimi të bëhet dhe dizinfektimi i tyre. Pastrimi i sifonëve të tualeteve sipas nevojave ditore në pavione. Larja bëhet me solucion dizinfektues. Në ambientet e tualeteve të përdoren solucione aromatike.

➤ **Pastrimi i zyrave dhe dhomave të personelit (mjekësor dhe atij mbështetës), laboratorët, farmacia, ergoterapia**

Me këtë shërbim do të kuptojmë: Heqja e mbeturinave nga koshat, fshirja e larja e dyshemeve, larja e xhamave dhe marrja e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në zyrë. Në dhomat e personelit ky pastrim të bëhet të paktën 1 herë në ditë. Laboratorët, Ergoterapia dhe farmacia të pastrohen të paktën 2 herë në ditë. Solucionet që do të përdoren duhet të jenë të lejueshme për këto ambiente.

➤ **Pastrimi i shtepive mbeshtetese**

Me këtë shërbim do të kuptojmë: Heqja e mbeturinave nga koshat, fshirja e larja e dysHEMEVE me solucion përkatës dhe marrja e pluhurave në të gjitha orenditë e vendosura në këto ambiente. Ky pastrim të bëhet të paktën 2 herë në ditë.

Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të kryhet të paktën një herë në javë

- Të pastrohen sipërfaqet e mureve dhe tavaneve. Aty ku muri është i lyer me bojë vaji apo pllaka të lahen me solucion.
- Të zhvendosen dollapet dhe mobiljet e mëdha dhe të pastrohet pjesa e mbrapme e tyre.
- Të pastrohen dritaret e fasadës si dhe dritaret e brendshme me solucion larës.
- Të pastrohen dyert e brendëshme dhe të jashtme me solucion larës.
- Pastrimet javore të bëhen sipas grafikut në ditën e përcaktuar.

Pastrimi i ambienteve të brendshme që do të kryhen të paktën një herë në muaj

- Do të pastrohet sistemi i të gjithë llojeve të ndriçimit (abazhurë, llampadarë etj).
- Pastrimet mujore të bëhen sipas grafikut në ditën e përcaktuar.

Dhomat e mjekimit

- Të pastrohen sa herë që është e nevojshme gjatë gjithë kohës që janë në përdorim.

Të gjitha dhomat

➤ Dhomat e pacientëve, infermieritë, dhoma e mjekimit, zyrat, ambientet e përbashkëta, laboratorit, ergoterapitë, parukeritë, palestra, magazina, kuzhina etj., duhet të pajisen koshat me qese plastike të zeza njëpërdorimshe për hedhjen e mbeturinave.

Dezinfektimi i dysHEMEVE, qosheve dhe tualeteve bëhet me lëndë dezinfektuese çdo ditë behet me lëndë dizinfektuese me bazë klori 5% (hipoklorit) çdo ditë. Kur përdoren dezinfektantë duhet të zbatohen pikat e përgjithshme të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore. Produktet që do të përdoren për dezinfektim duhet të jenë të certifikuar.

Detergjentet që duhet të vihen në dispozicion duhet të jenë të një cilësie të lartë, dhe duhet të kenë këto specifikime teknike:

Tretësit e përshtatshëm: Sprucim me ujë, shkumë, pluhur, CO₂. - Nuk duhet të jetë i ndezshëm. - Të mbahen në enë të mbyllura, të cilët të jenë të etiketuara. - Vlera e pH në 20^o Celsius – nga 7,00 në 30,00 g/l. - Tretshmëria në ujë: e pakufizuar. - Densiteti në 20^o Celsius – 1,0290 gr/cm³. - Viskoziteti në 20^o Celsius – 210 mPas. - Të jetë e biodegradueshme. Shkalla e eliminimit: >90%.

Në rast se materialet e pastrimit nuk janë të një cilësie të lartë, nuk do të pranohen nga AK. Furnizimi me materiale pastrimi duhet të bëhet sipas një itinerari të caktuar apo sipas nevojave dhe konsumimit, nën kujdesin e Supervizorit të Kontraktuesit i cili duhet të bëjë shpërndarjen e tyre dhe të sigurojë që mos të mungojë asnjëherë furnizimi.

Operatori duhet të bëjë furnizimin me materiale e detergjente pastrimi duke pasur parasysh ambientet e Spitalit.

Pastrimi i dyshemesë: Duke qenë se dyshemeja është me përbërje të ndryshme, edhe mënyra e pastrimit të saj duhet të bëhet në varësi të llojit të dyshemesë. Më poshtë po paraqesim një përshkrim mbi mënyrën e pastrimit dhe mjetet që duhet të përdoren përkatësisht:

Sipërfaqet e mermerit: Mermeri është një gur shumë delikat, i cili duhet të trajtohet me kujdes. Për pastrimin e një sipërfaqeje mermeri në mënyrë natyrale duhet të përgatitet një kovë me ujë të ngrohtë dhe të paktën 3 lecka microfibrë ose lecka të tjera të buta dhe thithëse, të lehta për tu shtrydhur. Fillimisht kalohet mbi mermer një copë e thatë për heqjen dhe thithjen e pluhurit. Nëse nuk ka njolla, mjafton një pastrim me leckë microfibrë e lagur me ujë të ngrohtë, e cila heq shenjat e papastërtive. Në rast se ka njolla, duhet të përdoret një sfungjer i butë pasi t'i jenë hedhur disa pika sapuni ekologjik ose me një sapun natyral (nuk duhet të përdoret kurrë product me pH acidic). Substancat që duhet të evitohen për pastrimin e mermerit janë ato acidike, lëngu i limonit, acidi citric, detergjente agresive dhe solucione të tjera gërryese, për shkak të delikatesës së mermerit. Duhet të shmangen edhe instrumentat dhe mjetet gërryese të cilat mund të çojnë në dëmtimin e mermerit në mënyrë të pakthyeshme. Nuk duhet të fërkohet asnjëherë biokarboni direkt në mermer, për mos ta gërvishtur. Ai duhet të lihet të veprojë (pasi të jetë përgatitur dhe tretur në ujë), dhe më pas të hiqet pa u fërkuar direkt për shkak të sipërfaqes delikate. Çdo ditë duhet të bëhet pastrimi me makineri i sipërfaqeve të mermerit, duke zbatuar kushtet dhe kërkesat teknike të përshkruara më sipër.

Pastrimi i sipërfaqes bëhet me shtupë me dy kova ujë, një për larje, një për shplarje. Mjetet e pastrimit për tualetet mbahen të veçanta, fshesa përdoret e kufizuar në ambientet pa shtretër dhe që kanë qarkullim të lartë (shkallë, koridore, etj.)

Operatori duhet të vendosë në dispozicion materiale shumë cilësore, për shkak të vetë cilësisë së lartë të strukturës së brendshme. Ato nuk duhet të jenë gërryese dhe duhet të jenë në të njëjtën kohë pastrues dhe higjenzues.

Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimin e plehrave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë.

Sanitarja gjatë pastrimit nuk duhet të prekë pacientet, aparaturat, dorezat e dyerve.

Personeli i shërbimit duhet të ketë uniformë të dallueshme nga personeli spitalor. Në uniformë duhet të dallohet logo e kompanisë, me ngjyrë të ndryshme nga uniforma e spitalit. Personeli duhet të instruktohet për mbrojtjen nga infeksionet spitalore sipas ligjit *“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve ngjitëse”*.

1. Në ambientet spitalore personeli i pastrimit duhet të përdori mjete mbrojtëse si doreza plastike, maska, këpucë gome etj.
2. Në ambjentet publike si koridore, salla, shkallë etj., të përdoren tabela provizore ku të paralajmërohet për dysheme të lagur e të rrëshkitshme.

-
3. Shërbimi i pastrimit duhet të vazhdojë gjatë 24 orëve pa ndërprerje (sipas ndarjes së orareve të përcaktuara në këtë argumentim).
 4. Te siguroje numrin e nevojshem te personelit per kryerjen e pastrimit ne te gjithë teritoret e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore. Ky personel duhet te jete i pershtatshem dhe i instruktuar per kryerjen e shërbimit te pastrimit, sipas rregullave dhe duhet te jete i pajisur me librezat shendetesore personale.
 5. Te siguroje bazen materiale te inventarit per pastrim si dhe materialet dezinfektante te pershtateshme dhe te lejueshme per perdorim ne ambjentet spitalore. Siguron inventarin per grumbullimin e mbeturinave ne dhoma, korridore etj.
 6. Per personelin e pastrimit siguron veshjet dhe mjetet mbrojtese ne pune te cilat do te jene specifike dhe me mbishkrimin perkates.
 7. Pastrimi do te behet i perditshem ne te 365 ditet e vitit.
 8. Pastrimi i dritareve dhe mureve behet çdo jave ne ditet e caktuara ne grafik.
 9. Pastrimi i dritareve nga jashte dhe i fasades se Spitalit do te behet dy here ne vit.
 10. Pastrimi ne dhoma nuk behet ne orarin e ngrenjes se ushqimit dhe ne oraret e kryerjes se vizitave te mjekut.
 11. Kontraktuesi kur merr ambjente ne perdorim nga e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore paguan qerane perkatese ne baze te VKM ne fuqi.
 12. Me mbarimin e kontrates i dorezon ato ne gjendje te rregullt. Shpenzimet qe ben per riparimin, mirembajtjen e nevojshme perballohen nga vete sipërmarresi.
 13. Kontraktuesi nderton stafin e vet drejtues. Ai cakton pergjegjesin e vet te pastrimit i cili ndjek, organizon e drejton punen ne spital.

Kontraktuesi ka per detyre:

- të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përbushjen e kontratës. Këto pajisje, makineri dhe vegla duhet që sipërmarresi ti sigurojë që me fillimin e punës.

Pastrimi i jashtëm

Me sipërfaqet e jashtme (rrugë, trotuare, sheshe) të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore do të kuptojmë të gjithë hapësirën rreth e përqark godinave (objektet e ndërtimit) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. Si më poshtë vijojmë:

Per objektet qe ndodhen brenda teritorit te Spitalit

- Siperfaqe truall brenda rrethues sipas planit rregullues te Bashkise mbetet **11,050m²**
- Siperfaqe e zene me ndertime ekzistuese eshte **2563.14 m²** , kati i dyte ne pavionin 4-5 eshte 663 m²
- Siperfaqia e zene me ndertimin e shtepise Mimoza eshte **180 m²** (ndertese dy kate me siperfaqe ndertimi 360m² sot perdoret si P.A.S)
- Siperfaqe e zen me ndertimin e ri eshte **988 m²**(3*988=2964m²)

- Siperfaqe totale e zen me ndertim eshte **3731.64 m²** (2563.14m² ekzistuese , 180m² shtepia Mimoza 988 m² ndertimi i ri
- Siperfaqe e zene me rruge \approx **4880 m²**
- Siperfaqe e gjelberuar \approx **2439 m²**

Te dhena per ambientet ne territorin e Qendres Komunitare

- Siperfaqia Brenda murit rrethues eshte \sim **1500 m²**
- Siperfaqia e zene me ndertim eshte 450 m² x per tre kate = 1350 m²
- Siperfaqia e zene me rruge eshte \approx 550 m²
- Siperfaqia e gjelberuar eshte \approx 500 m²

Sipas te dhenave te mesiperme nxjerrim se siperfaqe totale ndertime eshte:

$$2563.14 + 663 + 2964 + 360 + 1350 = 7900.14 \text{ m}^2$$

Siperfaqe totale e zene me rruge eshte:

$$4880 + 550 = 5430 \text{ m}^2$$

Siperfaqe e gjelbert eshte:

$$2439 + 500 = 2939 \text{ m}^2$$

Sherbimi i pastrimit të jshtëm perbehet nga keto procese pune:

Nr.	Pershkrimi i procesve te punes	Nj.m	Siperfaqja
1.	Shërbim Fshirje (Rrugësh,trotuare, sheshe) (4880m ² +550m ²)	m ²	5430
2.	Shërbim Larje (Rrugësh,trotuare,sheshe) (4880m ² +550m ²)	m ²	5430

Kontraktuesi eshte i detyruar te siguroje me shpenzimet e veta pajisjet, makinerite dhe veglat e punes qe nevojiten per permbushjen e kontrates. Keto mjete pune duhet qe kontraktuesi t'i siguroje qe me fillimin e punes.

Kontraktuesi do te pastroj (fshijë) çdo dite te gjithe siperfaqen e rrugeve brenda Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali", Vlore siperfaqen prej 5430 m², kur eshte e nevojshme edhe 2 here ne dite, do te pastroj bordurat ne anesoret e rrugeve nga barerat si dhe do te lyej bordurat me boje, te cilesise te larte, me resine 100% akrilike dhe e perzgjedhur per te siguruar nje mbrojtje afatgjate dhe te qendrueshme te siperfaqes. Eshtë ideale per lyerje te cdo siperfaqeje te jashtme dhe brendshme të perbëra nga beton, siperfaqe te suvatuara, dru, çimento , tulla. Aplikohet me lehtesi, pa probleme, si dhe kombinon bardhesine, fuqine mbuluese dhe rezistencen ndaj kushteve atmosferike (rrezet e diellit, shiu, lageshtia, smogu, mjegulla, uji i detit), tre here në vit. Kontraktuesi do te kryej larjen e rrugeve çdo dite heret ne mengjes, para ores 7.00 per periudhen 15 Mars - 30 Tetor, pra gjithsej 230 dite per nje siperfaqe prej 5430 m². Kontraktuesi do kryej cdo dite transportin e mbeturinave, (kur eshte e nevojshme edhe 2 here ne dite) te cilat jane perqendruar ne 1 pika grumbullimi me 6 kazane brenda territorit te spitalit.

Shërbimi i Pastrimit të ambienteve të jashtme që kërkohet do të jetë 16-orarësh sipas tabelës me të dhënat e sipërfaqeve si më poshtë:

Nr	Sipërfaqet e jashtme	Njësia	Sasia	Frekuenca dite/vite	Sasia vjetore
1	Shërbim Fshirje (Rrugësh,trotuare, sheshe)	m ²	5,430	365	1 981 950
2	Shërbim Larje (Rrugësh,trotuare, sheshe)	m ²	5,430	230	1 248 900

- Me pastrim të jashtëm do të kuptohet pastrimi i sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve, shesheve dhe të gjithë territorit pjesë që aktualisht përdoret nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore
- Bordurat duhet të mirëmbahen dhe lyhen me boje, te cilesise se larte, me resine 100% akrilike dhe e perzgjedhur per te siguruar nje mbrojtje afatgjate dhe te qendrueshme te siperfaqes të paktën tre herë në vit.
- Pastrimi (fshirja) e territorit do të kryhet jo më pak se një here në ditë. Pjesët e asfaltuara dhe të betonuara do të lahen me ujë të paktën 1 (një) herë në ditë sipas sezonit për të eliminuar pluhurat dhe mikrobet (por jo në ditët me shi).
- Territori i Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore në cdo moment duhet të jetë i pastër nga mbeturinat e ndryshme si letra, shishe plastike, amballazhe të ndryshme, bishtat e cigareve etj.
- Mbeturinat e grumbulluara nga pastrimi i Brendshëm dhe i jashtëm, të futen në qese plastmasi dhe të cohen në pikat e grumbullimit të mbeturinave, të cilat ndodhen jashte territorit të spitalit (tek koshi i grumbullimit te mbeturinave nga Bashkia Vlorë). Duhet ndërruar të paktën dy herë në ditë qeset plastike në koshat e vendosura në territorin e jashtëm të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlore.
- Në asnjë rast mbeturinat të mos digjen.
- Sipermarresi kryen larjen e rrugëve cdo ditë herët në mëngjes, para ores 7.00 për periudhen 15 Mars - 31 Tetor, pra gjithsej 230 ditë.

Materialet dhe mjetet profesionale të domosdoshme, që OE pjesëmarrës duhet të deklarojnë disponimin ose mundësinë e disponimit të tyre, të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës/kontratave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër:

AKSESOR PASTRIMI, DETERGJENT DHE KONSUMI

NR	Emërtimi i Artikujve	Njesia
1	Acid per pastrim WC (HCL)	Liter
2	Letra duarsh per tualete	Pako
3	Dizinfektant banjoje	Liter
4	Doreza gome	Pale
5	Fshesa merimangash	Cope
6	Fshesa pastrimi per ambjentet e jashtme (industriale)	Cope
7	Fshesa plastike + bisht te gjate	Cope

8	Fshese me sfungjer dhe gome per xhamat	Cope
9	Furça muri me bisht për lyerje me gëlqere	Cope
10	Furça pastrimi lavamani	Cope
11	Furça pastrimi për WC me mbajtese	Cope
12	Furca per larje muri me pllaka,me bisht	Cope
13	Boje me resine 100% akrilike (lyerje bordurash)	Liter
14	Hipoklorit kalciumi	Kg
15	Hipoklorit Natriumi (Na HCO3) 10-12 %	Liter
16	Kaci plerash me bisht plastike 20x20	Cope
17	Kosha plastik për mbeturina 15 kg	Cope
18	Kosha ambienti metalik me rrotullim	Cope
19	Kova larje me shtydhese komplet 20 lt (profesionale)	Cope
20	Kova pastrimi te thjeshta 5 lt	Cope
21	Lecka mikrofibra per larje xhami	Cope
22	Leter higjenike e paketuar (1pako 10 rulon)	Pako
23	Qese mbeturinash 50*60 (pako me 50 cope)	Pako
24	Qese mbeturinash spitali 50 x 80 te zeza (pako me 70 cope)	Pako
25	Sfungjer per pastrim hidrosanitaresh (1 pako 4 Cope)	Pako
26	Shkopa inoksi me gjatesi normale	Cope
27	Shtupa pambuku per larje dysHEMEJE 350 gr	Cope
28	Solucion lares per pllaka dysHEMEJE 1-5 lt	Liter
29	Solucion lares wC	Liter
30	Solucion lares xhamash	Liter
31	Solucion pastrimi parketi	Cope
32	Solucion per pastrim mobilje.	Cope
33	Solucion per zhbllokim lavamani 100 ml	Cope
34	Fshesa për fshirje ne te thate	Cope
35	Solucion zhbllokues banjosh	Cope
36	Solucion per pastrim kompjuterash	Liter
37	Solucion per pastrim mermeri	Liter
38	Leckë pllakash	Cope
39	Leckat Mop	Cope
40	Lares duarsh ne tulate	Liter

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Shërbim pastrimi i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, për nevoja të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë

Afatet e ekzekutimit:

Emërtimi i shërbimit	Përshkrimi	Sasia e sip. Për pastrim	Nr. i ditëve për pastrim 12 muaj	Sasia për 48 muaj	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Pastrim i brendshëm						
Shërbim pastrimi i brendshëm	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	7,900.14 m²	365	11,534,204.4 m²	Ambjentet e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
Pastrim i jashtëm						
Fshirje rrugësh	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	5,430 m²	365	7,927,800 m²	Ambjentet e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
Larje rrugësh	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	5,430 m²	230	4,995,600 m²	Ambjentet e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Ofrim i shërbimit sa më cilësor të shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.

Detyrat:

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Shërbime me frekuencë ditore. – Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve dhe open space. - Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore). - Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to. - Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.

- Pastrimi i dyshemeve, industriale, mermeri, me pllaka, parketi dhe kuarc të të gjitha ambienteve. - Pastrimi i ËC-ve, aksesorëve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit.

- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në ËC (letër higjienike, letër dhe likuid duarsh). - Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë. - Pastrimi i ashensorëve. - Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, salla mbledhjeve etj.).

Pastrimi i kangjellave të brendshme. - Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobileve brenda tyre. - Pastrimi i laboratorëve dhe ambienteve të shërbimit. - Pastrimi i dyshemesë me pllaka përpara derës hyrëse (në ambientit e brendshëm dhe të jashtëm) dhe në ambientin e sheshit rreth e përqark godinës.

Pastrimi i Oborrit, në cdo godinë të bëhet I përditshëm.

Shërbime me frekuencë periodike. - Pastrimi i Sallës së Konferencave dhe dy Sallave të Mbledhjeve (një herë në javë).

Pllakat e parkimit jashtë, dhe borsurat ndarëse të gjelbërimit. (tre herë në muaj).

Pastrimi i xhamave brenda (një herë në javë).

Pastrimi i ambienteve që shërbejnë për, Depo e Ujit, Dhomat e kaldajave, pastrim dyshemeje dhe merimangat (një herë në muaj).

Grafiku i kryerjes së shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme.

Lloji i Shërbimit Frekuenca e pastrimit

1 Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve dhe open space.

Çdo ditë 2 Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore).

Çdo ditë Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.

Çdo ditë Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.

Çdo ditë Pastrimi i WC-ve, aksesoreve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.

Çdo ditë Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër duarsh dhe likuid duarsh).

Çdo ditë Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.

Çdo ditë Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, salla mbledhjeve etj.).

Çdo ditë Pastrimi i kangjellave metalike të brendshme.

Çdo ditë Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobileve brenda tyre.

Pastrimi i laboratorëve dhe ambienteve të shërbimit.

*Përveç Shërbimeve sipas grafikut të mësipërm do të kryhen shërbime pastrimi të tjera, në kushte të jashtëzakonshme në funksion të mirëmbajtjes ditore të ambienteve të brendshme.

Punonjësit e Shërbimit: Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme, duhet të vihen në dispozicion punonjës pastrimi për turnin e parë, për turnin e dytë dhe për turnin e tretë përkatësisht për pranim, Hollin, për Akutin, shërbimet mbështetëse, për ambjentet e jashtëm (obrret), shtëpiza nr.2, për QKSHM, shtëpitë nr.1+3, për pavionin kronik, pavioni kronik burra.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambjentet e Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 8 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit, sipas objektit të prokurimit, Kodi III.1.A.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 28 (njëzet e tetë) punonjës, si më poshtë:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punonjës pastrimi/sanitar	24 (njëzet e katër)
3	Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara	2 (dy)
	Totali	28 (njëzet e tetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

a) Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi, dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b) Për punonjësit e pastrimit/ sanitar, të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

b.1) Nga numri total i punonjësve të pastrimit/sanitar (24 (njëzet e katër)), 2 (dy) prej tyre duhet të jenë të trajnuar dhe të pajisur me çertifikate të punimeve në lartësi të lëshuara nga shoqëri të licensuara nga ministria përkatëse, për të cilët përveç kontratës së punës, duhet të paraqitet edhe dokumentin/certifikatën e trajnimit për punimet në lartësi (të vlefshme).

c) Për punonjësit shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi në përputhje me mjetet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makinë per larjen e sipërfaqeve të jashtme (Autobot)	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
